



Kopshti i fëmijëve në pjesën gjermanofolëse të kantonit Bernë

Informacione për prindërit

Elterninformation Kindergarten
Albanisch

2 Kopshti i fëmijëve në pjesën gjermanofolëse të kantonit Bernë

Informacione për prindërit

Pasqyra e lëndës

Të dashur prindër	3
Mirë se erdhët në kopshtin e fëmijëve	4
Objektiva arsimore dhe forma të të mësuarit	6
Mbështetja e zhvillimit	8
Bashkëpunimi i prindërve me forcat mësimore	10
Organizimi i kopshtit të fëmijëve	12
Përkujdesja dhe shëndeti	14
Drejtoria e shkollës, autoritete dhe zyra të specializuara	15

Impressum

Herausgeberin und Copyright:

Erziehungsdirektion des Kantons Bern
Amt für Kindergarten, Volksschule und Beratung
www.erz.be.ch/akvb, akvb@erz.be.ch
Auflage Februar 2018

Të dashur prindër

Pasi fëmija jua ka mbushur katër vjeç, në gusht ai do të hyjë në kopshtin e fëmijëve. Hyrja në kopshtin e fëmijëve për ju dhe fëmijën tuaj është një ngjarje e veçantë.

Si prindër ju mund të kontribuoni shumë për mbarëvajtjen e vizitës së kopshtit të fëmijëve dhe mund ta shoqëroni dhe mbështetni fëmijën tuaj në rrugën e tij të mëtejshme të të mësuarit. Inkurajoni fëmijën tuaj të bëjë vetë sa më shumë gjëra që janë të mundshme. Me këtë ju e forconi vetëbesimin e tij, e nxisni pavarësinë e tij dhe mund t'ia lehtësoni atij hyrjen në kopshtin e fëmijëve dhe bashkëjetesën në një grup më të madh.

Që të mund të keni një përfytyrim të gjithanshëm për kopshtin e fëmijëve, ne i kemi përmbledhur informacionet më të rëndësishme.

Ne ju urojmë juve dhe fëmijës suaj një fillim të mbarë dhe më pas një kohë pa ankesa dhe tërheqëse në kopshtin e fëmijëve!

Drejtoria për Edukim

Udhëzim

Në disa komuna fëmijët e kopshtit të fëmijëve dhe të të dy klasave të para të shkollës mësohen plotësisht ose pjesërisht së bashku në mosha të përziera (Basisstufe ose Cycle élémentaire).

Informacione plotësuese për këtë gjeni nën:

www.erz.be.ch/basisstufe

www.erz.be.ch/cycle-élémentaire-de

Mirë se erdhët në kopshtin e fëmijëve

Hyrja në kopshtin e fëmijëve

Eintritt in den Kindergarten

Me hyrjen në kopshtin e fëmijëve fëmijës suaj i hapet një hapësirë e re e jetës, lojës dhe përvojës. Fëmija juaj takohet me një grup fëmijësh, të cilët ndryshojnë në aspektin e zhvillimit, nevojave dhe gjuhës së tyre si dhe prejardhjes së tyre sociale dhe kulturore.

Në kopshtin e fëmijëve fëmijët bashkohen në një bashkësi, në të cilën ata mund të luajnë me njëri-tjetrin dhe mund të mësojnë nga njëri-tjetri. Në kopshtin e fëmijëve fëmija juaj e ka mundësinë që të provojë gjëra të reja, të eksperimentojë dhe të krijojë. Nëpërmjet përvojave të shumëllojshme me të gjitha shqisat, ai mund të ndërtojë edhe më tej përftytyrimet e tij mbi sendet dhe lidhjet.

Forca mësimore për kopshtin e fëmijëve

Lehrperson für den Kindergarten

Klasa me fëmijët në moshën katër deri gjashtë vjeç udhëhiqet nga një forcë mësimore për kopshtin e fëmijëve. Në varësi nga numri i ose përbërja e nxënësve është e mundshme që edhe një forcë tjetër mësimore e mëson klasën ose që një ndihmë klase e mbështet forcën mësimore në mësim.

Forca mësimore i nxit dhe mbështet fëmijët individualisht sipas zhvillimit, aftësive dhe interesave të tyre. Ajo jep sugjerime, zgjedh forma të përshtatshme të të mësuarit, e organizon ecurinë e mësimi dhe vë në dispozicion materiale të reja mësimore, të cilat mundësojnë përvoja të reja dhe hapa të tjera të të mësuarit.

Në kopshtin e fëmijëve fëmija juaj e ka mundësinë që të provojë gjëra të reja, të eksperimentojë dhe të krijojë. Nëpërmjet përvojave të shumëllojshme me të gjitha shqisat, ai mund të ndërtojë edhe më tej përfytyrimet e tij mbi sendet dhe lidhjet.

Objektiva arsimore dhe forma të të mësuarit

Lehrplan 21

Mësimi në kopshtin e fëmijëve orientohet në Lehrplan. Lehrplan u shërben forcave mësimore nga kopshti i fëmijëve deri në vitin e 9-të të shkollës si busull, i cili i mbështet ato në planifikimin e mësimit.

Informacione të mëtejshme për Lehrplan 21 gjeni nën: www.erz.be.ch/lehrplan21

Loja dhe të mësuarit

Spielen und Lernen

Loja është një nga format më të rëndësishme të të mësuarit në kopshtin e fëmijëve. Loja ua mundëson fëmijëve që të zbulojnë rrugë të veta të të mësuarit dhe t'i ndjekin ato. Loja e nxit këmbënguljen, stimulon për për të bërë ushtrime dhe ofron sfida dhe mundësi të përshtatshme të të vepruarit.

Hapësira e kopshtit të fëmijëve është e pajisur me ambiente të larmishme të lojërave dhe të të mësuarit, nga të cilat fëmija juaj mund të rizgjedhë çdo ditë. Por ai inkurajohet po ashtu, që të pranojë një ofertë të lojërave dhe të të mësuarit, të cilën ai vetë ndoshta nuk do të kishte zgjedhur.

Duke u nisur nga të mësuarit të drejtuar nga interesat, të paqëllimshëm, në situata të jetës së përditshme dhe të lojës, të mësuarit me kalimin e kohës në kopshtin e fëmijëve bëhet gjithnjë e më pikësnyuar dhe sistematike. Fëmijët bëhen gjithnjë e më shumë të aftë, që t'i trajtojnë detyrat dhe porosinë e paracaktuara.

Të mësuarit nga njëri-tjetri

Voneinander lernen

Në grup fëmija juaj mëson bashkë me fëmijë të tjerë dhe nga këta. Fëmijët mësojnë që ka rregulla. Ata mësojnë që të sillen në situata të ndryshme në mënyrë të përshtatshme dhe t'i përputhin interesat e tyre me ato të fëmijëve të tjerë. Ata ushtrojnë që të tërheqin vetveten, të mbrojnë vetveten dhe të kërkojnë zgjidhje në situatat e konflikteve. Kjo i nxit kompetencat e tyre sociale.

Zhvillimi personal

Persönliche Entwicklung

Fëmijët i zgjerojnë në kopshtin e fëmijëve edhe kompetencat personale. Ata çohen në pavarësi, marrin përsipër bashkëpërgjegjësi dhe përjetojnë vetveten në mënyrë të efektshme. Me këtë ata e përforcojnë edhe vetëbesimin e tyre. Ata mësojnë që ta drejtojnë vëmendjen e tyre në një qëllim dhe t'i rregullojnë emocionet e veta. Ata mësojnë që t'i perceptojnë ndjenjat e tyre dhe të sillen në përputhje me situatën. Fëmijët zhvillojnë besim në aftësitë dhe shkathtësitë e tyre dhe mund t'i vlerësojnë këto gjithnjë e më mirë.

Bazat për fitimin e teknikave kulturore

Grundlagen für den Erwerb der Kulturtechniken

Fëmijët mësojnë që të shprehen dhe t'u hapen të tjerëve, të tregojnë përjetime dhe dëgjojnë tregime. Me këtë nxiten aftësitë gjuhësore dhe zgjerohet fjalori.

Fëmijët përgatiten për të mësuarit e leximit dhe të shkrimit, duke perceptuar rrokje dhe fjalë në këngë dhe vjersha. Edhe aftësitë motorike të imëta dhe aftësia e përfytyrimit për hapësirën dhe format zhvillohen më tej.

Në kontaktin duke luajtur me sasi dhe numra fëmijët i mësojnë lidhjet dhe rregullsitë.

Fëmijët i zgjerojnë në kopshtin e fëmijëve

edhe kompetencat personale.

Ata çohen në pavarësi, marrin përsipër

bashkëpërgjegjësi dhe përjetojnë

vetveten në mënyrë të efektshme.

Mbështetja e zhvillimit

Mbështetje dhe nxitje

Unterstützen und fördern

Fëmijët sjellin me vete në kopshtin e fëmijëve kushte, përvoja dhe kompetenca të ndryshme. Forca mësimore e regjistron gjendjen e zhvillimit të fëmijëve duke i vëzhguar dhe në bisedat me prindërit. Kështu ajo i dallon anët e forta, talentet dhe interesat si dhe gjëra, të cilat i shkaktojnë fëmijës akoma mundime. Me kuptimin e të përjetuarit dhe zhvillimit individual të një fëmije forca mësimore e planifikon dhe organizon punën me fëmijët.

Mbështetje shtesë

Zusätzliche Unterstützung

Fëmijë, të cilët për zhvillimin e tyre kanë nevojë për nxitje shtesë, marrin mbështetje me pikësnyim dhe impulse zhvillimi. Në marrëveshje me ju një person i kualifikuar shtesë mund t'i mbështetë fëmijët, p.sh. në zhvillimin gjuhësor ose motorik.

Gjermanisht si gjuhë e dytë

Deutsch als Zweitsprache (DaZ)

Fëmijë, gjuha amtare e të cilëve nuk është gjermanisht, sjellin me vete thesarin e vet të përvojës dhe të gjuhës që është i lidhur me gjuhën e parë. Në kopshtin e fëmijëve janë oferta në dispozicion, me të cilat nxiten në mënyrë të pikësnyuar fëmijë që rriten me shumë gjuhë. Por fëmija juaj ka në kopshtin e fëmijëve një start shumë më të lehtë, nëse e kupton që në fillim gjuhën e mësimin dhe kuptohet nga forca mësimore dhe fëmijët e tjerë.

Sa më herët bie fëmija juaj në kontakt me gjuhën gjermane, aq më lehtë ai mund ta mësojë atë. Prandaj fëmija juaj të paktën një vit para hyrjes në kopshtin e fëmijëve duhet ta ketë rregullisht mundësinë që ta dëgjojë dhe flasë gjuhën gjermane. Këtë ai mund të ushtrojë p.sh. në grupin e lojës, në qendrën e kujdesit ditor për fëmijë ose me fëmijë fqinjë.

Këshilla për rritjen me shumë gjuhë gjeni nën: www.erp.be.ch/hsk → Mehrsprachig aufwachsen

Me kuptimin e të përjetuarit dhe zhvillimit individual të një fëmije forca mësimore e planifikon dhe organizon punën me fëmijët.

Bashkëpunimi i prindërve me forcat mësimore

Bashkëpunimi

Zusammenarbeit

Bashkëpunimi me forcën mësimore dhe drejtorinë e shkollës i shërben nxitjes optimale të fëmijës suaj dhe është i obligueshëm për prindërit.

I gatshëm/e gatshme për kopshtin e fëmijëve

Fit für den Kindergarten

Forca mësimore për kopshtin e fëmijëve merr kontakt me prindërit që para fillimit të vitit shkollor.

Nëse fëmija juaj njihet me kopshtin e fëmijëve dhe forcën mësimore në një ditë vizite, mund të fitohet besim fillestar në çështjen e re.

Në broshurën «I gatshëm/e gatshme për kopshtin e fëmijëve» ose nën www.erz.be.ch/fit-fuer-den-kindergarten ju gjeni sugjerime, se si ju mund ta përkrahnit fëmijën tuaj në zhvillimin e tij dhe çfarë kontribuon për një start të suksesshëm në kopshtin e fëmijëve.

Informacione reciproke

Gegenseitige Information

Nëpërmjet informacioneve të rregullta reciproke dhe bisedave do të sqarohen parashikimet dhe qëllimet. Fëmijët mund të sillen ndryshe në kopshtin e fëmijëve në krahasim me sjelljet në rrethin shtëpiak. Prindërit dhe forcat mësimore këmbëjnë vrotimet dhe përvojat, që t'i kuptojnë fëmijët sa më mirë dhe që të mund t'i mbështesin dhe ndihmojnë ata sa më mirë.

Forca mësimore ju informon në kohë dhe rregullisht mbi punën e kopshtit të fëmijëve.

Kopshti i fëmijëve ju mbështet në edukimin dhe arsimin e fëmijës suaj. Nëse ju keni nevojë për informacione ose keni pyetje për kopshtin e fëmijëve dhe zhvillimin e fëmijës suaj, drejtohuni forcës mësimore të klasës.

Format e ndryshme të bashkëpunimit

Verschiedene Formen der Zusammenarbeit

Forca mësimore ka mundësi të zgjedhë forma të ndryshme bashkëpunimi me prindërit (p.sh. mbrëmjen e prindërve, letrën për prindërit, bisedat, shfaqjet për prindërit dhe fëmijët).

Në aktivitetet në kopshtin e fëmijëve dhe në bisedat me prindërit forcat mësimore dhe prindërit njihen më mirë dhe mund të ndërtojnë besim të ndërsjellë.

Biseda

Gespräche

Si forca mësimore, ashtu edhe prindërit mund ta dëshirojnë bisedën, për të shkëmbyer informacione dhe mendime ose për të sqaruar pyetje.

Biseda me prindërit

Standortgespräch

Një herë në vitin shkollor forca mësimore zhvillon një bisedë me prindërit. Në bisedë shkëmbehen vërtetime dhe bisedohet për

zhvillimin, përparime në të mësuarit, sjelljen gjatë punës, kompetencat personale dhe sociale të fëmijës.

Temat e biseduara protokollohen nga forca mësimore në një procesverbal të paracaktuar nga Drejtoria për edukim për bisedën me prindërit (temave nga një listë u vihet një kryq). Me lemë mund të protokollen, përveç kësaj, plotësime dhe marrëveshje të përbashkëta. Formulari është pjesë e një dosjeje dokumentesh, në të cilën ruhen më vonë edhe raportet e vlerësimit.

Vizitat

Besuche

Vizitat e prindërve në kopshtin e fëmijëve janë të mirëpritura në marrëveshje me forcën mësimore.

Nëpërmjet informacioneve të rregullta reciproke dhe bisedave do të sqarohen parashikimet dhe qëllimet.

Organizimi i kopshtit të fëmijëve

Kopshti i fëmijëve si pjesë e shkollës fillore

Kindergarten als Teil der Volksschule

Kopshti është një pjesë e mëvetësishme e shkollës fillore që zgjat njëmbëdhjetë vjet dhe është falas. Si rregull, kopshti zgjat dy vite. Çdo fëmijë që ka mbushur 4 vjeç deri më 31 korrik, hyn në gusht në kopshtin e fëmijëve. Vendimtare për hyrjen është mosha.

Prindërit e kanë mundësinë të lënë që fëmija i tyre për shkak të gjendjes së zhvillimit të hyjë një vit më vonë në vitin e parë të kopshtit të fëmijëve. Nëse ju dëshironi ta shfrytëzoni këtë mundësi, shënojeni atë në formularin e regjistrimit që do t'ju dërgohet nga komuna. Drejtoria e shkollës është në dispozicionin tuaj për një bisedë për vendimarrjen. Por ju mund të merrni këshillime edhe tek këshillimorja për edukim, mjekja juaj për fëmijët ose këshillimorja për nënat dhe baballarët.

Orari i kopshtit të fëmijëve

Kindergartenzeit

Numri i leksioneve mësimore (45 minuta) varet nga numri i javëve shkollore në vendbanimin tuaj. Në rast të 38 javëve shkollore këto janë 23 deri 26 leksione dhe në rast të 39 javëve shkollore këto janë 22 deri 25.

Reduktimi i orarit të mësimeve në vitin e parë të kopshtit të fëmijëve

Reduktion der Unterrichtszeit im ersten Kindergartenjahr

Gjatë vitit të parë të kopshtit të fëmijëve lejohet që fëmija juaj ta ndjekë kopshtin e fëmijëve me orar të reduktuar të mësimeve. Nëse ju e dëshironi këtë, tregojani atë drejtorisë së shkollës gjatë regjistrimit të fëmijës. Orari i mësimeve lejohet të reduktohet në maksimum vetëm me një të tretën. Qëllimi është që fëmija juaj të mësohet dalëngadalë me orarin e plotë të mësimeve.

Drejtoria e shkollës vendos mbi organizimin dhe zbatimin kohor të reduktimit të mësimeve.

Ndjekja e mësimit

Besuch des Unterrichts

Fëmijët e ndjekin kopshtin e fëmijëve sipas orarit rregullisht nga e hëna deri të premtën. Kohët e fillimit dhe të mbarimit paradite janë të njëjtat si në shkollë (kohë blloku). Një deri dy herë në javë zhvillohet mësimi edhe pasdite.

Kujdesuni që fëmija jua ta ndjekë mësimin në gjendje të çlodhur. Për mësimin dhe raste të veçanta si p.sh. ekskursione të përbashkëta kini kujdes që fëmija juaj të jetë i pajisur dhe veshur në mënyrë të përshtatshme.

Rruga për në kopshtin e fëmijëve

Kindergartenweg

Jashtë orarit të kopshtit të fëmijëve dhe rrugës për në kopshtin e fëmijëve dhe nga atje fëmijët janë nën përgjegjësi të prindërve. Ushtroni bashkë me fëmijën tuaj rrugën për në kopshtin e fëmijëve me qëllimin që ai mund ta bëjë me kalimin e kohën vetë.

Mungesat

Absenzen

Ju lutemi, lajmëroni në kohë forcën mësimore mbi mungesat (p.sh. për shkak të një sëmundjeje ose të një aksidenti të fëmijës suaj ose brenda familjes suaj, ndërimit të banesës, terminit tek mjeku dhe dentisti), por jo më vonë sesa para fillimit të mësimit. Në rast të një sëmundjeje si temperaturë, vjellje etj. fëmija juaj qëndron në shtëpi derisa ai është përsëri i shëndetshëm.

Dispencacione

Dispensationen

Për miratimin e dispencacioneve paraqitni katër javë paraprakisht një kërkesë të arsyetuar me shkrim tek drejtorja e shkollës. Dispencacione mund të jepen për arsye si p.sh. kremtimi i festave të larta fetare, ngjarje të rëndësishme familjare, vizita e një kursi në gjuhën dhe kulturën amtare (HSK).

Gjysmëdita të lira

Freie Halbtage

Fëmija juaj ka të drejtë për pesë gjysmëdita të lira në vit shkollor. Në këto gjysmëditë fëmija juaj mund të mungojë në mësim pa dhënë arsye. Nëse ju dëshironi që të shfrytëzoni një gjysmëditë të lirë për fëmijën tuaj, atëherë njoftojeni paraprakisht për këtë forcën mësimore të klasës. Gjysmëditat mund të merren veç e veç ose së bashku.

Kalimi në vitin e 1-rë shkollor të shkallës primare

Übertritt in das 1. Schuljahr der Primarstufe

Parimisht pas dy vjetësh në kopshtin e fëmijëve të gjithë fëmijët hyjnë në vitin e 1-rë të shkallës primare. Si përjashtim – në mënyrë të veçantë për shkak të gjendjes së zhvillimit – fëmijët mund të hyjnë në vitin e 1-rë të shkallës primare edhe një vit më herët ose më vonë. Në këtë situatë drejtorja e shkollës e urdhëron vendimin me kërkesën e forcës mësimore dhe në marrëveshje me prindërit.

Forcat mësimore të kopshtit të fëmijëve bashkëpunojnë me forcat mësimore të vitit të parë të shkollës. Projekte të përbashkëta ose ditë të vizitave të përbashkëta mundësojnë që fëmijët të përgatiten në shkallën primare dhe për kalimin.

Përkujdesja dhe shëndeti

Day school

Tagesschule

Si plotësim për kopshtin e fëmijëve në shumë shkolla ka një ofertë për shkollim ditor. Shkollimi ditor mund të përfshijë përkujdesje herët në mëngjes, gjatë drekës (me drekë) dhe pasdite. Ndjekja e shkollës ditore bëhet vullnetarisht. Prindërit, sipas të ardhurave të tyre, mbajnë një pjesë të shpenzimeve të përkujdesjes dhe paguajnë ushqimin.

Drejtorja e shkollës mund t'ju informojë, cilat ofertat zhvillohen në komunën tuaj. Informacione të përgjithshme për shkollat ditore gjeni nën:

www.erz.be.ch/tagesschulen

Mundësi të tjera të përkujdesjes për fëmijët jashtë familjes (qendra të kujdesit ditor për fëmijë, prindër ditorë etj.) gjeni nën:

www.gef.be.ch → Familie

Vizita mjekësore

Ärztliche Untersuchung

Një vizitë mjekësore dhe kontrolli vjetor i dhëmbëve nga një dentist ose një dentiste janë për të gjithë fëmijët të obligueshme dhe falas.

Nëse ka nevojë për trajtime, do t'ju informojë mjekja ose mjeku. Kostot për këtë i mbajnë prindërit vetë.

Drejtoria e shkollës, autoritete dhe zyra të specializuara

Drejtoria e shkollës

Schulleitung

Drejtoria e shkollës është kompetente për udhëheqjen pedagogjike dhe organizative të shkollës dhe të kopshtit. Me pyetje lidhur me organizimin e shkollës ose me një situatë që nuk mund të zgjidhet me forcën mësimore ju mund të drejtohuni drejtorisë së shkollës.

Autoriteti i komunës

Gemeindebehörde

Autoriteti kompetent i komunës është përgjegjës që fëmijët të ndjekin kopshtin e fëmijëve sipas legjislacionit kantonal dhe përcaktimeve të komunës.

Inspektorati shkollor

Schulinspektorat

Mbikëqyrjen kantonale mbi shkollën fillore e ka inspektorati shkollor rajonal.

Këshillimoret për edukim

Erziehungsberatungsstellen (EB)

Këshillimorja kantonale për edukim në rajonin tuaj ju këshillon në raste të veçorive në zhvillimin e fëmijës suaj dhe në çështje të veçanta të edukimit:

www.erz.be.ch/erziehungsberatung

Informacione të mëtejshme për shkollën fillore gjeni nën:

www.erz.be.ch/elterninfo

